

MIMOZA ZEKAJ

NDËRNDIKIMET GJUHËSORE NË TË FOLMEN E GJIROKASTRËS

Ndikimi i një gjuhe në gjuhën tjetër quhet interferencë apo ndërndikim gjuhësor. Interferenca gjuhësore mund të bëhet në çdo fushë gjuhësore, si në fonologji, në morfologji, në leksik, në sintaksë si dhe në semantikë. Mirëpo, interferenca më e shpeshtë bëhet në fushën e leksikut. Kjo ndodh për arsye se fjalët barten lirisht jo vetëm si rezultat i kontaktit të bilingëve, por edhe për shkak se në gjuhë vazhdimisht shtohet numri i fjalëve të reja për të emërtuar objektet, idetë dhe situatat e reja¹. Njerëzit gjithmonë kanë pasur kontakte ndërmjet tyre. Ata kanë shkëmbyer sende e materiale shpirtërore, kanë pushtuar territore të reja, kanë bartur prej njërit te tjetri përvojën dhe diturinën e tyre, e bashkë me to edhe një pjesë të gjuhës së tyre². Arsyet e këtij ndërndikimi janë më shumë shoqërore dhe psikologjike, se sa gjuhësore dhe mund ta lidhim me ndikimin në ligjërimin e shumë folësve dhe jo vetëm të një folësi. Ndërndikimi i trajtave të të folurit shpesh është i dyanshëm, por ne në punimin tonë kemi zgjedhur vetëm një kahje, atë të ndikimit në të folmen e Gjirokastrës.

Gjirokastra është një nga qytet e mëdhenj më jugorë të Shqipërisë³. Në përbërjen e këtij qyteti dhe të krahinave që e rrethojnë, pjesën më të madhe të popullsisë e përbën ajo me kombësi shqiptare, por nuk mungon as pakica kombëtare greke, pakica vllahe e rome. Duke kundruar pozitën gjeografike, mënyrën e jetesës së këtyre banorëve, të cilët në rrjedhë të shekujve kanë pasur marrëdhënie të ndërsjella me popujt fqinj, përndarjen demografike e fetare të këtij qyteti, vëmë re se krahas shkëmbimeve materiale e shpirtërore, kanë shkëmbyer edhe fjalët. Në këto ndërndikime kanë ndikuar sa faktorët gjeografikë, aq edhe ata historikë. Bashkëjetesa shekullore me minoritetin grek, pushtimi për disa shekuj nga Turqia, pranimi i besimit islam, sundimi shekullor i osmanëve në Ballkan, prania e drejtpërdrejtë a e tërthortë në territorin shqiptar e disa gjuhëve evropiane, kanë lënë gjurmët e veta në repertorin gjuhësor gjirokastrit.

E folmja e qytetit të Gjirokastrës bën pjesë në strukturën ligjërimore të arealeve të Jugut, duke shpalosur vlera informuese, emocionale, diferencuese, ngjyresën krahinore të Toskërishtes jugore. Në këtë të folme, si pasojë e fqinjësisë, bashkjetesës, të kontakteve të vijueshme social – ekonomike, kulturore, fetare brenda qarkut ballkanik dhe atij evropian, ndërkëmbehen

¹ V. Nuhiu, *Ndikimet ndërgjuhësore*, Prishtinë, 1990, f. 18.

² Po aty, f. 5.

³ M. Totoni. *Vëzhgime rreth së folmes së qytetit të Gjirokastrës*, në SF, 1966/1, f. 77.

fjalë, sintagma, fraza një dhe shumëgjuhëshe⁴. Kjo ka sjellë mbartjen e mjeteve të shprehjes të njërës gjuhë në tjetrën, në shtegtimin e fjalëve e sendeve të idiomës greke e orientale në idiomën shqipe dhe anasjelltas, domethënë me ndërndikimin gjuhësor e sidomos me dukurinë e huazimit⁵. Në të gjejnë përdorim të dendur turqizma e greqizma dhe disa huazime të tjera, të cilat duke i parë nga pikëpamja statistikore, vëmë re se disa prej gjuhëve fqinjje të drejtpërdrejta të shqipes, si gjuhët sllave, me të cilat marrëdhëniet kanë qenë të pandërprera, kanë ndikuar më pak në leksikun e saj, vështruar në tërësi. Kjo dëshmon se për huazimin gjuhësor më shumë se sa afërsia gjeografike e takimi truallësor, luajnë rol faktorë të tjerë, si: politikë, kulturorë, fetarë, ekonomikë⁶.

Leksiku i gjuhës së sotme shqipe, si dhe brenda tij leksiku i së folmes së Gjirokastrës, përfshin fjalë shumë të vjetra të burimit indoevropian ose nga gjuhë të tjera, fjalë që janë ruajtur gjatë shekujve në jetën e popullit tonë dhe ato që janë krijuar e kanë hyrë në përdorim sipas nevojave, fjalë që kanë lindur gjatë zhvillimit shoqëror, ekonomik, kulturor e mendor të popullit shqiptar gjatë periudhave të ndryshme historike, fjalët dialektore e krahinore, qofshin këto të gjuhës së shkruar e të gjuhës së folur.⁷ Ndërndikimet ndërmjet gjuhësh të ndryshme janë kryesisht në rrafshin leksikor. Gjatë kundrimit të së folmes së Gjirokastrës vëmë re se ndikimet e përdorura në të shpesh plotësojnë pamjen e arealit gjeografik me ngjyresën historike, nga ana tjetër vëmë re se kjo e folme jo vetëm i ka pranuar elementet e huaja leksikore, si huazime gjuhësore, por disa prej tyre i ka përshtatur, u ka ndryshuar pjesërisht përbërjen e tyre fonemore, duke aktivizuar disa mekanizma për të realizuar kërkesat e saj.

Ndikimet leksikore që ndihen në të folmen e Gjirokastrës, duke u nisur nga disa kriteret klasifikimi, të trajtuara gjerësisht nga gjuhëtarë shqiptarë dhe të huaj, mund t'i klasifikojmë:

Sipas origjinës

Fjalë të burimit grek. Interferencat gjuhësore të greqishtes mbi gjuhën shqipe në përgjithësi dhe mbi të folmen e Gjirokastrës në veçanti, duke ditur edhe shkaqet gjeopolitike të bashkëjetesës njëshekullore të popullit shqiptar me Minoritetin grek, ndihen më tepër si krahinorizma dhe pjesë e thjesht ligjërimin. Pjesa më e madhe e tyre përdoret në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa ngjyrimet stilistikore, por me qëllime të caktuara. Shumica e tyre në ditët e sotme mbeten në kufijtë dialektorë dhe në leksikun pasiv, si: *dhangë, cimbill, angjillë, alonar, dhipato, anagullë, avli, oreks, stolis, frondillë, dhiple, fanero,*

⁴ E. Çabej, *Huazimet greke*, në Studime gjuhësore, Prishtinë, III, 1976, f. 46.

⁵ Xh. Lloshi, *Shqipja standarde në rrethanat e dygjuhësisë*, në SF, 2001/3-4, f. 48.

⁶ E. Lafe, *Vendi i orientalizmave ndër huazimet shqipe*, në SF, 1993/1-4, f. 37.

⁷ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005, f. 212-213.

Ndërndikimet gjuhësore në të folmen e Gjirokastrës

dhogë, dhotur, holas, erimi, honeps, karfos, llahtaris, kanaqeps, llambro, kondo, palo, niq, martiris, llams, maçalis, mono, mballos, koqinall, krisaf, kumbiem, ngalas, paraponi, tiliks, tendos, papsi, jaurt, psonis, protare, stromë, vjaset, zoi, skami, skorllan, siloisem, i dhifisi, e thapsi, rrokanis, çokanis, kanakar, nasqiris, kaliqe, lipsu, dhipato, jatro, protare, zahar, rizi, karkanaqe, kanaqeps etj. Një pjesë e tyre dalin si emërtime të sendeve të lokalizuara më së shumti në pjesën jugore, si: *gliko, zali, stafidhe, dhiozmo, karpuz, manxura, zahar, karkanaqe, patomë, kaliqe, vasiliko* etj. Në përdorime të caktuara disa prej tyre përdoren për të individualizuar personazhe e situata të caktuara, si: *berdu e tërë, pilivri, i feksin sitë, patai, xivo-gavo, në dhipato, nikoqire, anagulë, dhams e feks*.

Orientalizmat. Një tipar i përbashkët që i shquan gjuhët e Ballkanit nga gjuhët e tjera indoevropiane të kontinentit, është edhe prania e një shtrese fjalësh të ardhura nga turqishtja, të cilat disa studiues i quajnë thjesht turqizma e disa orientalizma, meqë një pjesë e mirë e tyre janë me burim nga arabishtja e nga persishtja dhe turqishtja ka qenë vetëm gjuha ndërmjetëse⁸. Në studimet e ndryshme që janë bërë në lidhje me huazimet turke, është vënë në dukje se ato kanë prekur më shumë gjuhën e qyteteve sesa atë të fshatrave dhe kanë hyrë kryesisht nga gjuha e folur⁹. Edhe në ditët e sotme qyteti i Gjirokastrës ka si pasuri arkitekturore ndërtime që lidhen me familjet e administratës së Perandorisë Osmane. Veç elementeve të kulturës turke, ne gjejmë edhe shumë fjalë orientale, që sot mund të shihen si barbarizma, por që në vitet '30 të shekullit të kaluar kanë qenë pjesë organike e kompetencës leksikore, sidomos e brezit të vjetër të gjirokastritëve¹⁰. Edhe në ditët e sotme, sidomos te brezi i tretë, vëmë re që një pjesë e këtyre orientalizmave dhe greqizimeve janë pjesë organike e leksikut të përditshëm të tyre.

Në gjuhën shqipe nga turqishtja kanë hyrë më fort fjalë emra dhe më pak mbiemra e folje¹¹. Si emrat, mbiemrat dhe foljet u janë përshtatur rregullsisht të sistemit fonologjik dhe të strukturës gramatikore të shqipes, ashtu si gjithë fjalët e tjera të kësaj gjuhe. Kjo dukuri vihet re edhe në leksikun me burim turk të përdorur në të folmen e Gjirokastrës. Pjesa më e madhe e turqizimeve përdoren si emërtime të veshjeve, gatimeve, orendi shtëpiake, emërtime të administratës. Ja disa prej tyre: *torvë, xhep, tenxhere, murtala, qollopite, hasude, xhumba, xhaxhesh, sahan, filxhan, sepet, juk, huj, homorillë, gjilap, gjulaki, gajtanaq, futa, fiqir, elbeza, dizbai, çirek, çarçaf, çember, davet, bilimbash, bekri, mekam, meqeme, okllai, pazari, sade, damur, xullufe,*

⁸ E. Lafe, *Vendi orientalizmave ndër huazimet e shqipes*, në SF, 1993/1-4, f. 35.

⁹ E. Hysa, *Elemente turke në strukturën e fjalës në gjuhën shqipe*, në SF, 1998/3-4, f. 149.

¹⁰ V. Memisha, *Veçori të shenjimit gjuhësor urban në veprën e Musine Kokalarit*, në "Studime për fjalën shqipe", Tiranë, 2011, f. 247.

¹¹ Sh. Demiraj, *Rreth huazimeve turke në gjuhën shqipe*, në SF, 2004/3-4, f. 23.

xhanfes, zapana, muftiu, agai, shahitëtë, imam, jemeni, mëhalesë, mahmudije, davet, sabah, beshkllëk, xhehmem, bazube, katenxhika, xhevap etj.

Një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë fituar vlera stilistikore dhe përdoren për të shprehur qëndrime subjektive, ndjenja positive a negative, shqetësime të ndryshme si: *shahtizmeno, tëllësëm, xhind, texhara, seiz, mashalla, jaman, ana-dane, asaman, allaj, avdall* etj. Përdorimi i tyre shpesh na ndihmon për të zbuluar pozitën shoqërore të përdoruesve, rrethin ku ata veprojnë e punojnë, marrëdhëniet ndërmjet tyre, madje, ndikojnë edhe në njohjen e psikologjisë së tyre.

Në të folmen e Gjirokastrës, ashtu si në mbarë shqipen, pamja tingullore e huazimeve sllave dhe e toponimeve me burim sllav nuk paraqet gjurmë të vjetra, gjë që tregon se kontaktet e sllavëve me shqiptarët janë më të vona në krahasim me pjesën tjetër të Ballkanit¹². Edhe studiuesia A. Desnickaja nënvizon se: *përsa u përket huazimeve sllave në shqipe, mund të flitet jo për "huazime" në kuptimin e zakonshëm të fjalës, por më tepër për një precipitim të shtresave të tëra leksikore të gjuhës së asimiluar*¹³. Zona e Gjirokastrës në krahasim me vise të tjera jugore (të Vlorës, Kaninës, rrjedha e poshtme e Semanit etj.) u prek më pak prej këtij ndikimi. Ndikimet prej bullgarishtes, përbëjnë edhe huazimet më të vjetra prej sllavishtes në këtë të folme¹⁴. Edhe në ditët e sotme në të folmen e Gjirokastrës këto huazime kanë përdorim të kufizuar, si: *vërsnik, kyç, fëshnik, zakon, porosit, dremit, strehë, vadis, bazdravicë, kličo, velenxë, tërkuzë, çudit* etj. Nga sllavishtja kanë mbetur edhe disa gjurmë në toponomastikë e në folklor¹⁵, si emra lumenjsh, fshatrash: *lagjja Granicë, zona e Zagories, lumi Drino, lumi i Bistricës*.

Latinizmat. Duke lënë jashtë trajtimin tonë anën historike të huazimit të fjalëve me burim latin (nuk është synim i punimit tonë), do të përmendim vetëm ndikimin e latinishtes në fushën e folklorit e të besimeve popullore, i cili sipas prof. Çabej është interesant¹⁶. Këtë ndikim e kemi vërejtur më shumë në përralla dhe në krijime të tjera popullore, duke përmendur figura të tilla si: *kuçedra, dragoi, orët, zanat* etj.

Në të folmen e Gjirokastrës vëmë re ligjërime e regjistra të ndryshëm gjuhësorë, të cilët shpalosin mozaikun e jetës gjirokastrite, i lidhur ngushtë me jetën shqiptare në tërësi, por edhe me shtresëzimet e kulturave të ndryshme me të cilat ka kontaktuar gjithmonë. Këto ndërndikime janë bërë pjesë e ligjërimit

¹² A. Omari, *Përsëri rreth huazimeve më të vjetra sllave në shqipe*, në SF, 1999/1-2, f. 73.

¹³ J. Gjinari, *Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore*, në SF, 1966/2, f. 167.

¹⁴ M. Kore, *Huazimet sllave dhe veçoritë e tyre*, në "Gjirokastra vështrim historik, gjuhësor, etnologjik", Tiranë, 2014.

¹⁵ E. Çabej, *Huazimet sllave*, në Studime gjuhësore nr. 3, Prishtinë, 1976, f. 59.

¹⁶ Po aty, f. 55.

bisedor të tyre, saqë shpesh i merr edhe si pjesë e qenësishme dhe e domosdoshme të shenjimit gjuhësor gjirokastrit. Duke u mbështetur te trajtimet e shumta teorike nga gjuhëtarë shqiptarë dhe ata botërorë, këtyre interferencave leksikore, mbështetur në disa faktorë të tjerë sociolinguistikë, mund t'u bëjmë edhe disa klasifikime të tjera, pavarësisht origjinës së tyre.

Klasifikimi sipas fushave tematike

Gjatë kundrimit të leksikut të kësaj të folmeje, vëmë re se huazimet përdoren për karakterizime të fushave të ndryshme konceptore dhe jo si emërtesa të tepërta. Duke parë njësitë që emërtojnë, fushat tematike më të dukshme të këtyre fjalëve janë:

1. Fjalë që emërtojnë veprime dhe gjendje emocionale, si: *silloisem, kselhas, pataks, holas, frondillë, feks, llahtar, kusuret* etj.
2. Fjalë që emërtojnë gatimet familjare, si: *karkanaqe, kulaç, petëra, osa, gliko, çorbë, baklava, kabuni, skordhjan, hasude, musaka* etj.
3. Fjalë që emërtojnë mjete dhe orenditë shtëpiake, si: *filxhan, sepet, sahan, kamare, pisus, tenxhere, shtresa, sixhade, sufra, tepsi, minder, velenxë, buxhak, mashë, farasha, çarçaf, stromë, sunduk, gjim, okllai* etj.
4. Fjalë që emërtojnë bimë dhe lule, si: *karpuz, dhiozmo, rigon, qipariz, kroker, stafidhe, manxura* etj.
5. Fjalë që emërtojnë veshje dhe sende në funksion të veshjeve, si: *paramandë, cfongar, qostek, jelek, sade, boshta, jemeni, samur, ferexhe, pelluz, llambro, pazene, sade të natës, komolizon, çitjane, anteri, feste, dizbai, ormaçe, fanellë, sqafill, koqinall, frakazon* etj.
6. Emërtime të kultit, si: *Myfti, Imam, dhespot, veqil, evlat, kallogre* etj.

Duke parë përdorimet e ndryshme të këtyre ndikimeve, vëmë re se në pjesën më të madhe të tyre, këto njësi leksikore janë përshtatur edhe nga pikëpamja fonetike, gramatikore e semantike me korpusin leksikor të të folmes së Gjirokastrës.

Duke u nisur nga **mënyra e përqasjes dhe integritit** me strukturën fonologjike, gramatikore, semantike e leksikore të të folmes, huazimet mund t'i grupojmë:

1. Fjalë të huazuara që ruajnë përbërjen fonemore dhe kuptimin e gjuhës nga kanë burimin: *gliko, zali, avgellë, cimbill, jaurt, fanero, frondillë, kanaqeps, honeps, psunë, paraponi, kumbisem, leros, ngalas, moçalis, llambro, palo* etj. (greqizma); *tëllësëm, sade, toz, xullufe, xhehnem, asaman, davet, fiqir, juk, mekam, xhind* etj. (turqizma).
2. Fjalë të huazuara që kanë pësuar ndryshime semantike në përdorime të caktuara në të folmen e Gjirokastrës. Ja disa prej tyre: *rrufit, shtrigë, pllakos, mashalla, papsi, qeveri*.
3. Fjalë të huazuara që janë përdorur përkohësisht në të folmen e Gjirokastrës dhe kanë dalë nga përdorimi, pra përbëjnë shtresën e vjetruar të

leksikut, si: *nigjah, çember, mexhite, shëndre, saraj, tertip, sarrëk, malldarë, hajale, bilimbash, bekri, anagulë*.

E folmja e Gjirokastrës përmban fjalë, shprehje apo sintagma në gjuhën greke, turke dhe shumë pak latine e sllave, të cilat në shumicën e rasteve vendosen sipas pozicionit të ligjëruesit, duke ndërkëmbyer kodin e tij pjesërisht a plotësisht. Folësi shprehet sipas grupit shoqëror që përfaqëson, sipas krahinës nga rrjedh, sipas ndjenjave dhe ngjyimeve pozitive apo negative që mbart, duke bërë pjesë të leksikut të tij disa greqizma e orientalizma. Nga ana tjetër, vëmë re përdorimin e shumë shprehjeve e njëjive frazeologjike, të cilat janë të mbushura me leksik të huazuar dhe në disa raste fjalët e huaja janë vatra organizuese të anës kuptimore dhe formale. Në të folmen e Gjirokastrës kanë zënë vend edhe fjalët e huaja, të cilat në asnjë çast nuk janë ndier si teprime a deformim gjuhe, por janë parë si pjesë e gjuhës së përditshme dhe më rrallë si ngjyrim artistik. Por, nga ana tjetër, duke kundruar të folmen e Gjirokastrës, vëmë re se merr një vlerë të veçantë mendimi shkencor i gjuhëtarit Eduard Sapir se “*Gjuha është sigurisht rezistuesi më i pavarur, më i madh i të gjitha dukurive shoqërore. Forma e saj vetjake më lehtë prishet se sa përçahet*”.

BIBLIOGRAFI

- A. Lamaj, *Leksiku poetik në lirikën popullore të Jugut*, Fier, 2001.
 A. Omari, *Përsëri rreth huazimeve më të vjetra sllave në shqipe*, në SF, 1-2, 1999.
 E. Çabej, *Huazimet greke*, në “Studime gjuhësore III, Prishtinë, 1976.
 E. Çabej, *Huazimet sllave*, në “Studime gjuhësore III”, Prishtinë, 1976.
 E. Hysa, *Elemente turke në strukturën e fjalës në gjuhën shqipe*, në SF, 3-4, 1998.
 E. Lafe, *Vendi i orientalizmeve ndër huazimet e shqipes*, në SF, 1-4, 1993.
 J. Gjinari, *Mbi disa elemente sllave në të folmen veriore të Shqipërisë*, në SF, 2, 1966.
 J. Gjinari, Shkurtaj Gj., *Dialektologjia*, Tiranë, 2003.
 J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005.
 M. Kore, *Gjirokastra, vështrim historik, gjuhësor, etnologjik*, Tiranë, 2014.
 M. Totoni, *Vëzhgime rreth së folmes së qytetit të Gjirokastrës*, në SF, 1, 1966.
 Sh. Demiraj, *Rreth huazimeve turke në gjuhën shqipe*, në SF, 3-4, 2004.
 V. Bici, *Çështje të dygjuhësisë në shkollat e pakicave*, Tiranë, 2001.
 V. Memisha, *Veçori të shenjimit gjuhësor urban në veprën e M. Kokalarit*, në “Studime për fjalën shqipe”, Tiranë, 2011.
 V. Nuhui, *Ndikimet ndërgjuhësore*, Prishtinë, 1990.
 Xh. Lloshi, *Shqipja standarde në rrethanat e dygjuhësisë*, në SF, 3-4, 2001.